




REPUBLIKA E KOSOVË AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT АГЕНЦИЈА ПРОТИВ КОРРУПЦИЈЕ ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep.	03-02/DPK	Nr Prot.
Dep.		Br Prot.
Nr. i faq		Prot No.
Broj stranica		Data
Nr. pages		Date
		31.08.2016
PRISTINE		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.08.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2062-16, për Zyrtarin e lartë, z.Nikola Nojkiç –Këshilltar komunal në Komunen e Klokotit, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2062-16, për Zyrtarin e lartë, z. Nikola Nojkiç – Këshilltar komunal Klokot, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Nojkiç është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç`rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Nojkiç është deklaruar se brenda afatit do t`i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar së pari kërkesën për ndryshime në ARBK ((DPK/Dpki-03-02/2786/16), e pastaj edhe informatat mbi biznesin “Nikola Nojkiç” IIB (DPK/DPKI-03-02-2848/16), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, z. Nojkiç tashmë ka hequr dorë nga drejta e të qenurit person i autorizuar në këto biznese, duke emëruar në këtë pozitë një person të besuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor Agjencisë Kundër Korrupsionit



Hasan Preteni /



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11 (stav 1.1), članom 5 (stav 1 tačka 1.5), članom 18 (stav 10 i 11) Zakona br. 03/L-159 o Agenciji protiv Korupcije kao i članom 19 (stav 11) Uredbe br. 01/2014 o radu Agencije protiv korupcije, Direktor Agencije protiv korupcije dana 31.08.2016 doneo je ovu:

O D L U K U

I. Zaključuje se slučaj sa br. AKK-03-02-2062-16, za visokog zvaničnika, g .Nikola Nojkić – opštinski savetnik u Opštini Klokot, jer se izbegla situacija konflikta interesa pri vršenju javne funkcije..

II. Slučaj može biti ponovo otvoren u bilo koje vreme kada se predstave nove okolnosti.

O b r a z l o ž e n j e

I. Otvoreni slučaj pod osnovanom sumnjom za konflikt interesa tokom vršenja javne funkcije, sa br. AKK-03-02-2062-16, za visokog zvaničnika, g. Nikola Nojkić – Opštinski savetnik Klokot, a istovremeno i ovlašćeno lice u privatnom poslovanju, tretiran je prema predviđenom zakonskom postupku, za sprečavanje konflikta interesa pri vršenju javne funkcije (Zakon br. 04/L-051).

Visoki zvaničnik, g. Nojkić kontaktiran je od strane službenika Agencije protiv korupcije, kojom prilikom je obavešten o situaciji u kojoj se nalazi, kao i o promenama koje mora izvršiti, kako bi se izbegla situacija konflikta interesa pri vršenju njegove javne funkcije

Visoki zvaničnik, g. Nojkić izjavio je da će unutar roka izvršiti potrebne promene u poslovanju kako bi izbegao situaciju konflikta interesa pri vršenju njegove javne funkcije.

U međuvremenu, on, pri Agenciji protiv Korupcije, poslao je prvenstveno zahtev za izmenu u KARB ((DPK/Dpki-03-02/2786/16), i onda je prosledio i informacije o poslovanju “Nikola Nojkić” IB (DPK/DPKI-03-02-2848/16), od strane Kosovske Agencije za registrovanje biznisa (KARB) gde se vidi da, g. Nojkić već se odrekao od prava da bude ovlašćeno lice u ovom poslovanju, uz imenovanje na ovom položaju poverljivo lice, čime je i izbegao konflikt interesa pri vršenju njegove javne funkcije.

II. U skladu sa Članom 18, stav 11 Zakona br. 03/L-159 o Agenciji protiv korupcije. Agencija može da ponovo otvori slučaj u bilo koje vreme ako se predstave nove okolnosti.

Stoga, odlučilo se kao u izreci ove odluke.

Odluka se dostavlja:

- Visokom javnom zvaničniku
- Direktor OSK
- g./gđa. (odgovorni službenik)

Direktor Agencije protiv korupcije

